

## RELACION

### **PËR PROCEDURËN E PARAQITJES SË KËRKESËS, AFATET KOHORE, PËRGJEGJËSITË DHE ROLET E PËRDORUESVE TË SISTEMIT**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektvendimi "Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit" propozohet në zbatim të nenit 14 pika 1 e ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, i cili ngrihet me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Financave, me qëllim përfshirjen e programeve të strehimit social dhe aplikimit për të përfituar fonde nga buxheti i shtetit, nëpërmjet portalit e-Albania .

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi "Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit" është në përputhje të plotë me ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social" të ndryshuar. Projektvendimi plotëson kuadrin ligjor të kërkuar nga Strategjia e Strehimit Social 2016-2025 miratuar me Vendimin nr. 405, datë 01.06.2016, të Këshillit të Ministrave.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTU LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektvendimi "Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit" propozohet në zbatim të nenit 14 pika 1 e ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar i cili përfshin institucionet bazë që janë zbatuese të ligjit për strehimin social, duke pasqyruar kështu një situatë reale të hapave që janë ndërmarre me zbatimin e ligjit organik dhe në mënyrë që të gjitha aplikimet për programet e strehimit të bëhen nëpërmjet portalin e-Albania

*Projektvendimi "Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e*

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" të ndryshuar.

- a) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me nenin 100, pikën 1 dhe pikën 2 të nenit 118 të Kushtetutës:* Akti propozohet nga organi kushtetues si Ministri i Financave dhe Ekonomisë, dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, i cili ka tagrin të miratojë këtë akt. Bazuar në nenin 14 pika 1 e ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, jemi në kushtet e plotësimit të kërkesave kushtetuese të parashikuara në nenin 100 të Kushtetutës për nxjerrjen e akteve nënligjore për arsye se: (i) ligji material përcakton organin publik i cili ka tagrin të urdhërojë nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor, (ii) ligji, i cili shërben si bazë ligjore e aktit të propozuar, autorizon në mënyrë të shprehur nxjerrjen e aktit nënligjor (iii) ligji parashikon çështjet që duhen rregulluar si dhe parimet në bazë të cilave nxirret akti.
- b) Bazuar në këtë parashikim të ligjit, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, propozon aktin përpara organit që ligji ka autorizuar, Këshillit të Ministrave.
- c) *Përputhshmëria e aktit të propozuar me qëllimin e dispozitës përkatëse të ligjit, në funksion të propozimit:* Ligji për strehimin social ka të përcaktuara qartë edhe modalitetet që duhet të plotësojë akti sa i takon qëllimit të miratimit. Konkretisht, 14 pika 1 e ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar parashikon se: procedura e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit.
- d) *Përputhshmëria e aktit me legjislacionin ndërkombëtar:* Akti nuk lidhet drejtpërdrejt me ndonjë akt ndërkombëtar.

---

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektvendim nuk ka si objektiv të përafrohet me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

---

"Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit"

Projektvendimi propozohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë në kuadër të zbatimit të politikës së qeverisë shqiptare në fushën e strehimit social, me qëllim që të përfshijë të gjitha aplikimet për programet e strehimit social në sistemin e online si dhe të përcaktojë mënyrën e aplikimit nëpërmjet këtij sistemi. Kjo do të lehtësojë procedurën si për aplikantët ashtu dhe për punonjësit e njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Projektvendimi është i strukturuar në 2 Kre, si vijon:

Kreu I përmban 3 pika të cilat në to parashikohet qëllimi i këtij akti, bazën ligjor në të cilën do të dalë ky akt si dhe parashikimin se nga ku do të aksesohet dokumentacioni i nevojshëm.

Kreu II, parashikon procedurën e aplikimit afatet kohore për çdo hap si dhe rolet e punonjësve në system. Pika 1 e 2 parashikon fazat e aplikimit. Pika 3 parashikon se Struktura përgjegjëse për strehimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, merr aplikimet e kërkuesve dhe në rastet kur kërkesa e aplikantit rezulton se ka të meta në dokumentacion, kjo strukturë, brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës në sistemin e-Albania, njofton aplikantin nëpërmjet sistemit e-Albania të korrigjojë pasaktësitë, duke përcaktuar afatin 5 (pesë) ditor për plotësimin e tyre. Kur kërkuesi nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar, kërkesa refuzohet dhe njoftohet nëpërmjet sistemit e-Albania në rubrikën mesazhet e mia. Pika 4 parashikon marrjen e njoftimit mbi aplikimin. Pika 5 ka parashikuar se Strukturat përgjegjëse për strehimin pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ose zyra e shërbimit me një ndalesë e dedikuar për këtë qëllim, ofron ndihmë aktive për kërkesën në sistemin e strehimit në portalin qeveritar e-Albania, duke kryer plotësimin e formularëve të aplikimit për përfitimin nga programet e strehimit social për kërkuesit që kanë pamundësi për të aksesuar vetë në sistem. Kjo me qëllimin e lehtësisë për ato kategori të cilat e kanë të pamundur për shumë arsye. Pika 6 specifikon të gjithë fazën e dytë sa i takon procedurës, dokumenteve dhe afateve të tjera për plotësimin e fazës së dytë. Pika 7 parashikon rastin kur aplikantët nuk rezultojnë fitues duke specifikuar dhe rrugët ligjore për të cilat aplikuesi ka të drejtë të ndjekë. Pika 8 përcakton se në fazën e dytë, dosja e çdo kërkuesi e cila ngarkohet në sistemin e-Albania, duhet të përmbajë dokumentacionin që vërteton deklaratimet e bëra në fazën e parë. Dokumentacioni që kërkohet dhe ngarkohet në fazën e dytë është ai i përcaktuar në pikën 16 të vendimit nr. 384, datë 12.6.2019, me përjashtim të aktverifikimeve që kryen në terren njësi e vetëqeverisjes vendore lidhur me kushtet e banesës. Pika 9 parashikon se dokumentacioni i parashikuar pikën 8 të këtij kreu, ngarkohet nga vetë kërkuesi, me përjashtim të rasteve kur sigurimi i tyre është i pamundur për shkak të situatave të dhunës në familje, e vërtetuar me urdhër mbrojtjeje apo urdhër i

“Për procedurën e naraçitës së kërkesës afatet kohore, nënriçitë dhe rolet e

menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata. Pika 10 përcakton rastet se kush quhen rast emergjente për strehim. Pika 11 deri në 13 përcakton detyrat e punonjësve të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe hapat që duhet të ndërmmarin sa i takon aplikimit. Pika 14 parashikon se Njësitë e vetëqeverisjes vendore informojnë çdo vit ministrinë përgjegjëse për strehimin për nevojat për strehim, të identifikuara në përputhje me këtë vendim, nëpërmjet kërkesave për strehim social.

Në fund parashikohet, në përputhje me kushtetutën, se hyrja në fuqi e aktit është pas botimit në Fletore Zyrtare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Me zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen ministria përgjegjëse për strehimin, dhe të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**


Ky projektvendim u hartua nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) si ministria përgjegjëse për strehimin. Projektvendimi do të dërgohet për mendim në AMVV, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme,

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky projektvendim nuk mbart kosto të tjera shtesë.

**MINISTËR**

**ERVIN METI**



**“Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e nëndomësve të sistemit”**